



www.d4d-ks.org

Democracy for Development

Demokraci për zhvillim

Demokratija za razvoj

Instituti Demokraci për Zhvillim  
Analizë e shkurtë e politikave | Prishtinë, 2021

# KOSTO E PABARAZISË: FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE SË GRAVE KANDIDATE





# KOSTO E PABARAZISË: FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE SË GRAVE KANDIDATE

Prishtinë, korrik 2021.

Përgatitur nga:

**Valëza Zogjani**

# FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

---

Të drejtat e autorit ©2021. **Demokracia për Zhvillim (D4D).**

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Ky raport është publikuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) me mbështetje nga Ambasada Britanike në Prishtinë. Përmbajtja e këtij dokumenti në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet pasqyrim i qëndrimit të Ambasadës Britanike në Prishtinë.

### PËRMBAJTJA

Përmbledhje ekzekutive.....	6
Hyrje .....	9
Metodologjia.....	11
Si financohen fushatat zgjedhore? .....	12
Financimi i fushatës zgjedhore dhe zgjedhshmëria e grave kandidatë .....	14
Zgjedhshmëria e grave dhe financat partiake .....	17
Rrugëtimi në zgjedhje për deputetë .....	18
Financimi i fushatës zgjedhore .....	19
Sfidat kryesore në rrugën për deputetë.....	26
Financimi i fushatës zgjedhore në sytë e subjekteve politike .....	27
Përfundime dhe rekomandime .....	29
Për subjektet politike .....	30
Për politikëbërësit .....	31
Për shoqërinë civile .....	31

# FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

---

## TABELA E FIGURAVE

Figura 1: Gratë anëtare të Parlamentit (në përqindje) krahasuar me anëtarët e përgjithshëm të parlamentit në Kosovë .....	16
Figura 2: Gratë anëtare të Parlamentit (në numër) përmes kuotës gjinore krahasuar me numrin total të grave deputete të Parlamentit në Kosovë.....	17
Figura 3: Përfaqësimi partiak i të anketuarave .....	19
Figura 4: Kosto financiare e fushatës zgjedhore .....	19
Figura 5: Ndarja e kostos financiare të fushatës zgjedhore .....	20
Figura 6: A keni pasur qasje ne fonde nga partia politike për derivate gjatë udhetimeve brenda fushatës zgjedhore? .....	21
Figura 7: A keni pasur qasje në vetura të partisë për udhëtime nëpër tubime elektorale gjatë fushatës zgjedhore? .....	21
Figura 8: A keni pasur qasje në vullnetarë/punëtorë logjistikë nga partia politike gjatë fushatës zgjedhore për të ju ndihmuar gjatë fushatës? .....	22
Figura 9: Pagimi i hapësirave publike për takime dhe tubime me qytetarë .....	22
Figura 10: Në përgjithësi, a ndjeheni të diskriminuara në procesin e ndarjes së resurseve humane brenda partisë (për PR, komunikim, vozitje, sigurim) si dhe atyre financiare gjatë fushatës elektorale? .....	23
Figura 11: A keni pasur mbështetje financiare nga subjekti politik për promovim të postimeve tuaja (Post boosts) në rrjete sociale gjatë fushatës elektorale? .....	24
Figura 12: Mundësitë e (pa)barabarta për qasje në paraqitje mediale.....	24
Figura 13: A mendoni se mbështetja e subjektit rreth paraqitjeve mediale ka ndikim në zgjedhshmërinë e kandidateve? .....	25
Figura 14: A mendoni se paraqitjet mediale të grave ose mungesa e tyre, luajnë rol në (mos)zgjedhshmërinë për deputete? .....	25

---

## KOSTO E PABARAZISË:

---

Figura 16: A mendoni se mbështetja e subjektit rreth paraqitjeve mediale ka ndikim në zgjedhshmërinë e kandidatëve? .....26

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përmes kësaj analize synohet të kuptohet lidhshmëria mes financimit të partive politike dhe pjesëmarrjes politike të grave, duke u nisur në premisën se financimi i fushatës zgjedhore ka ndikim direkt në zgjedhshmërinë e grave për ulëse legjislative. Duke pasur parasysh sfidat që gratë kandidatë për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës kanë në procese zgjedhore, specifikisht si pasojë e mungesës së financimit të fushatës zgjedhore, kjo analizë tenton të hedhë dritë mbi praktikatat e subjekteve politike në Kosovë në distribuimin gjinor të fondeve partiake të dedikuara për fushata zgjedhore.

Duke përdorur hulumtim dokumentar, përkatësisht analizën e kornizës ligjore që rregullon çështjet e financimit të subjekteve politike dhe fushatave zgjedhore, si dhe hulumtimin parësor të realizuar me gra kandidatë për deputete të gjashtë subjekteve politike në Kosovë në shtatë legjislaturat e fundit të Kuvendit – përkatësisht gra kandidatë nga Lëvizja Vetëvendosje, Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Partia Socialdemokrate, dhe Nisma Socialdemokrate, si dhe me zyrtarë financiarë të këtyre subjekteve politike, raporti analizon koston e zhvillimit të fushatës zgjedhore si dhe nivelin e mbështetjes së subjekteve politike për kandidatët në lista zgjedhore në përgjithësi, dhe grave kandidatë në veçanti. Konkretisht, duke marrë parasysh nivelin jo të kënaqëshëm të përfaqësimit të grave deputete në Kuvendin e Kosovës, raporti tenton të kuptojë nëse mungesa e mbështetjes së duhur financiare për fushatë zgjedhore të grave kandidatë për deputete ndikon në zgjedhshmërinë e tyre për ulëse parlamentare.

Të gjeturat kryesore nga intervistat me gra kandidatë për deputete, si dhe zyrtarë financiarë nga subjektet politike të lartpërmendura në këtë raport, janë:

- ~ 50% e të anketuarave tregojnë që kosto financiare e zhvillimit të fushatës zgjedhore për zgjedhje parlamentare kap shifrën prej 2000 deri në 5000 euro për një kandidatë.
- ~ Fushatat zgjedhore e 50% të të anketuarave financohen nga mjetet vetanake, dhe 50% e të intervistuarave pohojnë se shpenzimet zgjedhore mbulohen në kombinim me mjete vetanake dhe mjete nga subjektet politike.

## KOSTO E PABARAZISË:

---

- ~ 75% e të anketuarave nuk marrin asnjë mbulim financiar për derivate të veturave përgjatë udhëtimeve në kohë fushate, dhe vetëm 25% e grave kanë qasje në veturat e subjekteve politike për t'i shfrytëzuar për takimet gjatë fushatës zgjedhore.
- ~ Qasje në vullnetarë dhe asistencë logjistikë nga subjektet politike për organizim dhe koordinim të aktiviteteve elektorale kanë vetëm 38% e të anketuarave.
- ~ 50% e të anketuarave pagujnë individualisht hapësirat publike që shfrytëzohen për takime dhe tubime elektorale me qytetarë.
- ~ 75% e të anketuarave ndjehen të diskriminuara brenda subjekteve politike në procesin e ndarjes së resurseve humane dhe financiare gjatë fushatës zgjedhore.
- ~ 50% e të anketuarave konsiderojnë që rregullimi i brendshëm i subjekteve të tyre politike lidhur me paraqitjet mediale të kandidatëve në kohë fushatë ofron mundësi deri diku të barabarta mes burrave dhe grave kandidate, ndërsa 13% konsiderojnë se rregullimi i subjekteve të cilave u takojnë diskrimon tej mase gratë.
- ~ 100% e të anketuarave konsiderojnë se mbështetja e subjekteve politike lidhur me paraqitjet mediale ka rol në zgjedhshmërinë e tyre si deputete.
- ~ Vetëm 13% e të anketuarave mendojnë se mosprezenca e grave kandidate në media nuk luan rol në zgjedhshmërinë e tyre si deputete.
- ~ Vetëm 1 në 4 respondente (25%) pohojnë që brenda subjekteve të tyre politike ka transparencë në menaxhimin e resurseve financiare duke ofruar qasje të plotë në menaxhimin financiar.
- ~ Vetëm 25% e respondenteve thonë që për subjektet e tyre çështjet e grave janë rrenjësores dhe se gratë janë pjesë e gjithë procesit të menaxhimit dhe shpërndarjes së resurseve financiare gjatë fushatës zgjedhore.
- ~ Asnjëra nga subjektet politike të intervistuar nuk kanë rregullore të brendshme për fonde të veçanta për të mbështetur gratë kandidate në fushatë zgjedhore.

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

---

- ~ *Subjektet politike konsiderojnë që nuk kanë praktika diskriminuese për gratë kandidate në zgjedhje, duke përfshirë ndarjen e fondeve dhe resurseve humane në kohë fushate.*

## HYRJJE

Megjithëse pjesëmarrja dhe përfaqësimi politik i grave është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit, gratë mbeten kryesisht të nënpërfaqësuar në politikë. Të dhënat tregojnë se burrat ende mbajnë mbi 75% të ulëseve parlamentare në të gjithë botë.<sup>1</sup> Në Kosovë, përqindja më e lartë e mandatave të fituara nga gratë shkon pak përtej kuotës minimale legjislative, me 36% të grave deputete në legjislaturën e tetë të dalë nga zgjedhjet e vitit 2021.<sup>2</sup>

Sidoqoftë, përqindja e përfaqësimit të grave në politikë është e një rëndësie të madhe. Së pari, përfaqësimi politik i grave ka ndikim të rëndësishëm në politikat e përgjithshme. Ligjvënëset gra kanë më shumë gjasa t'i shërbejnë interesave të grave dhe të shtyjnë përpara legjislacion të rëndësishëm që

është i dobishëm për gratë. Së dyti, ligjshmëria e sistemeve politike demokratike varet nga prania e grave ligjvënëse. Pasja e një përbërje jo të barabartë gjinore në institucionet e rëndësishme vendimmarrëse zvogëlon rregullat e proceseve demokratike që legjitimojnë sistemin politik.<sup>3</sup>

Megjithëse shumica e vendeve e njohin të drejtën ligjore për gratë për të marrë pjesë në politikë mbi një bazë të barabartë me burrat, mundësia e barabartë për përfaqësim zyrtar nuk përkthehet domosdoshmërisht në një rritje të konsiderueshme të përqindjes së grave në pozicione të rëndësishme të pushtetit politik.<sup>4</sup> Pabarazitë politike, sociale dhe ekonomike mbeten faktorë kritikë që i ndalojnë gratë të përfitojnë plotësisht nga mundësitë politike. Në

---

<sup>1</sup> Unioni Ndër-Parlamentar. (2021). Marrë nga: <https://data.ipu.org/women-averages?month=4&year=2021>

<sup>2</sup> Kuvendi i Kosovës. (2021). Marrë nga: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/deputetet/>

<sup>3</sup> Jones MP. (1998) Gender Quotas, Electoral Laws, and the Election of Women: Lessons from

the Argentine Provinces. Comparative Political Studies.

<sup>4</sup> Hughes, Melanie & Paxton, Pamela & Krook, Mona. (2017). Gender Quotas for Legislatures and Corporate Boards. Annual Review of Sociology. 43. 10.1146/annurev-soc-060116-053324.

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

---

rrethana të tilla, për të siguruar praninë e barabartë të grave në politikë, përfaqësimi numerik i grave në popullatën e përgjithshme duhet të reflektohet edhe në përfaqësimin e tyre në politikë, dhe veprime të tilla si ndryshimi i ligjeve zgjedhore janë një domosdoshmëri.<sup>5</sup>

Në Kosovë, gratë dhe burrat kanë mundësi të ndryshme për pjesëmarrje në jetën publike. Kjo ndodh për shkak të një sërë faktorësh që kontribuojnë në pabarazitë ekzistuese gjinore, nisur nga kultura dhe traditat rigjide patriarkale që prodhon elektorat rrjedhimisht konservator me ide të paracaktuara për rolet gjinore të grave dhe burrave në fushë publike, si dhe mungesës së vullnetit politik dhe mbështetjes brenda subjekteve politike për të ndihmuar fuqizimin politik të grave. Faktor i rëndësishëm i mirëmbajtjes së hendekut ekzitues gjinor në politikë janë edhe financat e munguara për gra politikane, sidomos në kohë të fushatës zgjedhore.

Termi financa politike nënkupton përdorimin e parave ose të burimeve të

tjera materiale për aktivitete politike. Sipas Fondacionit Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES), sistemet transparente dhe të përgjegjshme të financave politike luajnë rol kyç në integritetin e procesit politik dhe sigurojnë një fushë të barabartë loje për partitë politike dhe kandidatët zgjedhorë. Rregulloret e përcaktuara qartë dhe të zbatuara drejt në praktikë mund të zvogëlojnë përparësitë konkurruese për kandidatët më të pasur, të shuajnë blerjen e votave si dhe abuzimin me burimet shtetërore, dhe të rrisin besimin e qytetarëve në sistemin politik.<sup>6</sup> Për më tepër, janë financat politike në kohë fushate, dhe siguri që ndarja e këtyre resurseve bëhet në baza të barabarta mes grave dhe burrave, që determinon edhe suksesin apo zgjedhshmërinë e kandidatëve në zgjedhjet në të cilat garojnë.

Në Kosovë ka mungesë të madhe të studimeve, dhe trajtimit në përgjithësi, të çështjes së financimit të fushatës zgjedhore nga prizmi gjinor. Përderisa problematika e mungesës së financimit

---

<sup>5</sup> Ibid

<sup>6</sup> IFES. *Political Finance*. Marrë nga: <https://www.ifes.org/issues/political-finance>

të barabartë gjinor brenda subjekteve politike për kandidatet gra dhe burra diskutohen prekazi në debate publike, studimet empirike janë të munguara pikë së pari nga praktika e mbyllur dhe përgjithësisht jotransparente e subjekteve politike në menaxhimin e financimit politik në kohë fushatash zgjedhore. Për të kontribuar në këtë temë, ky studim merr për bazë përvojën e grave candidate nga subjektet më të mëdha në Kosovë, për të parë ndërlidhjen mes financimit politik dhe zgjedhshmërisë së tyre si deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

## METODOLOGJIA

Përmes këtij raporti analizohet ndikimi i financimit të fushatës zgjedhore dhe mbështetjes së subjekteve politike ndaj grave candidate për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhshmërinë e tyre për ulëse parlamentare. Për të arritur këtë qëllim, raporti nxjerr të dhënat përmes një kombinimi të metodave hulumtuese, të cilat janë gjeneruar dhe analizuar në periudhën mars-prill 2021.

Studimi është i organizuar si më poshtë: kapitulli i parë shqyrton qasjen metodologjike të analizës, duke sqaruar metodat dhe instrumentet e përdorura në nxjerrjen dhe analizimin e të dhënave. Kapitulli i dytë ofron një pasqyrë të përgjithshme të legjislacionit që rregullon financimin politik në Kosovë, dhe atë që siguron pjesëmarrjen e barabartë të grave në politikë. Kapitulli i tretë paraqet dhe trajton rezultatet e intervistave me gra candidate për deputete, si dhe kapitulli i katërt ofron përfundimet e analizës dhe rekomandime për hulumtime të mëtejshme dhe masa të nevojshme politike për ndryshime.

Të dhënat e para bazohen në hulumtim dokumentar, përkatësisht në analizimin e kornizës ligjore që rregullon çështjet e financimit të subjekteve politike dhe fushatave zgjedhore në Kosovë, kornizës ligjore për barazi gjinore në institucione publike, si dhe të dhënave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për nivelin e përfaqësimit të grave deputete në Kuvendin e Kosovës. Për më tepër, për të kuptuar më mirë ndikimin që

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

---

financimi i fushatave zgjedhore ka në nivelin e përfaqësimit politik të grave, hulumtimi shërbehet me burime sekondare relevante akademike dhe praktike të fushës.

Grupi i dytë i të dhënave është gjeneruar përmes hulumtimit parësor, i realizuar së pari përmes intervistave të strukturuar me gra kandidatë për deputete nga gjashtë parti parlamentare ndër vite në Kuvendin e Kosovës, përkatësisht nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Partia Socialdemokrate, dhe Nisma Socialdemokrate. Gjithsej tetë gra janë intervistuar për të kuptuar përvojën e

tyre dhe kostot e zhvillimit të fushatës zgjedhore - ndër to kandidatë të suksesshme dhe të pasuksesshme në garën për ulëse në Kuvendin e Kosovës. Së dyti, për të kuptuar organizimin dhe praktikën operuese, si dhe për të vlerësuar se sa janë në fokus çështjet e grave kandidatë në financat e subjekteve të përmendura më lart, janë intervistuar zyrtarë financiarë të këtyre subjekteve. Për fund, të dhënat janë validuar përmes fokus grupit me ekspertë të fushës nga rradhët e shoqërisë civile në Kosovë. Limit të këtij studimi paraqet mostra e vogël e grave kandidatë të intervistuar, prandaj rezultatet janë indikative por janë validuar me intervista me zyrtarë të financave të partive politike si dhe me fokus grup me ekspertë të fushës.

## SI FINANCOHEN FUSHATAT ZGJEDHORE?

Financimi i fushatave zgjedhore të partive politike shihet si parakusht për funksionimin e rregullt dhe efektiv të procesit zgjedhor. Mungesa e fondeve partiake të dedikuara për fushatë zgjedhore pamundëson partitë politike që të artikulojnë idetë dhe planprogramet e tyre elektorale para

votuesve, dhe rrjedhimisht pamundëson bërjen e zgjedhjeve të informuara për qytetarët që votojnë. Në Kosovë, megjithëse korniza ligjore mbulon në mënyrë adekuate financimin e partive politike, financimi i fushatave zgjedhore konsiderohet praktikë jotransparente dhe përgjithësisht e mbyllur.

## KOSTO E PABARAZISË:

---

Sipas Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike në Kosovë, burimet kryesore financiare dhe materiale të subjekteve politike në Kosovë përbëhen nga pagesat e anëtarësisë, kontributet dhe financimi nga buxheti i Republikës së Kosovës.<sup>7</sup>

Në kuadër të financimit nga kontributet për subjekte politike, ato lejohen të marrin kontribute nga persona fizikë në vlerë të maksimum 2000 eurove në vit, si dhe nga persona juridikë deri në 10,000 Euro gjatë një viti.<sup>8</sup> Ndërsa, nga buxheti i shtetit, subjektet politike përfitojnë nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike i cili funksionon në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përmes kësaj mbështetje, e cila përfshin buxhet jo më të madh se 0,17% të buxhetit të Republikës së Kosovës dhe ndarje proporcionale në mes të subjekteve politike të përfaqësuara në

Kuvend në bazë të numrit të ulësve për atë mandat, subjektet politike financojnë aktivitetet e tyre parazgjedhore dhe zgjedhore për zgjedhje lokale dhe qendrore, financimin dhe punën e Grupeve Parlamentare, si dhe financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike (përfshirë financimin e degëve të subjekteve politike).<sup>9</sup> Me ligjin për ndryshim-plotësim 04/L-058/2021, të Ligjit bazik për Financim të Subjekteve Politike 03/L-174, parashihet që fondi mund të përdoret edhe për financimin e njërive të organizimit të grave dhe të rinjve të subjekteve politike.<sup>10</sup>

Përderisa Ligji për Financim të Subjekteve Politike ndalon donacionet e drejtëpërdrejta për kandidatët për zgjedhje lokale dhe qendrore, duke kërkuar që mjetet të kalojnë përmes subjektit politik,<sup>11</sup> donacionet private

---

<sup>7</sup> Gazeta Zyrtare. (2010). Ligji nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike. Neni 4. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>

<sup>8</sup> Ibid. Neni 5

<sup>9</sup> Ibid. Neni 6

<sup>10</sup> Gazeta Zyrtare. (2012). Ligji nr. 04/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-174 për

financimin e subjekteve politike. Neni 3, pika 1.3. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2795>

<sup>11</sup> Gazeta Zyrtare. (2013). Ligji nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-058. Neni 11, pika 4.

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

---

mbesin ndër format më të shpeshta të financimit të fushatave zgjedhore të kandidatëve meqë ligji nuk parasheh obligimin për deklarim të kontributeve direkte të kandidatëve politikë, por obligon vetëm partitë që të deklarojnë pranimin e kontributeve. Kjo në fakt konsiderohet të jetë ndër flamujt e kuq kryesorë të këtij ligji, meqë edhe pse financimi privat konsiderohet mjet legjitim dhe i nevojshëm për fushëveprimin e partive politike dhe kandidatëve politikë, hapësira për keqpërdorime të mjeteve si dhe

mundësia e marrjes së fondeve të dala nga aktivitetet joligjore prej grupeve me qëllime të caktuara politike.

Mungesë tjetër serioze e këtij ligji është edhe mospasja e qasjes gjinore në rregullimin e financimit të fushatave zgjedhore të subjekteve politike. Mungesa e qasjes në mënyrat e financimit të partive politike, dhe ndarjes së buxhetit me veçanti gjatë fushatave zgjedhore, paraqet vështirësi për të zhvilluar një analizë analitike.

## FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE DHE ZGJEDHSHMËRIA E GRAVE KANDIDATE

Gratë në Kosovë, pavarësisht nga përparimi marginal në disa fusha, mbeten të nënpërfaqësura në politikë dhe vendimmarrje. Përkundër ekzistimit të garancive kushtetuese dhe ligjore sa i përket barazisë gjinore në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, zbatimi i tyre në praktikë mbetet minimal.

Si përmbledhje, gratë përbëjnë vetëm 35% të asambleve komunale në Kosovë, 36% të parlamentit, 20% të pozicioneve të larta vendimmarrëse në nivelin komunal dhe 33% në nivel ministrot. Aktualisht ka vetëm pesë grua ministre nga gjithsej 15 ministri, ndërsa nuk ka gra kryetare të komunës nga 38 komuna (KQZ, 2017).

---

Marrë nga: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8866>

---

## KOSTO E PABARAZISË:

---

Në rrafshin ligjor, Kosova, që nga viti 2000, përmes Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme, aplikon kuotë gjinore legjislative prej 30% për gjini të nënpërfaqësuar në Parlament. Në anën tjetër, Ligji për Barazi Gjinore, i miratuar në vitin 2015, thekson se "përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse". Në rrafshin praktik, subjektet politike garuese në zgjedhje i referohen standardeve minimale për përfaqësim të parapara nga Ligji për zgjedhje të përgjithshme në Kosovë, duke përfshirë vetëm kërkesën minimale prej 30% të grave të përfaqësuar në këto lista. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e grave në Parlament asnjëherë nuk ka arritur të jetë e barabartë me atë të burrave deputetë.

Që nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2007, kur pjesëmarrja e grave deputete


në Parlament ishte saktë 30%, përfaqësimi i grave në këtë institucion ka pasur trend të lehtë pozitiv ndër vite. Pjesëmarrja më e lartë e grave deputete në Parlamentin e Kosovës është arritur në vitin 2021, me gjithsej 36%, apo 43 deputete gra.

Mungesa e të dhënave empirike e pamundëson krijimin e ndërlikohjes dhe vlerësimit të saktë se sa ndikon financimi drejt zgjedhjes së kandidatëve nga subjektet politike. Megjithatë është e ditur që financimi ka një relacion pozitiv tek zgjedhjet, dhe kështu paraqet një rën nga mjetet kryesore që shpërfaqin më shumë qëndrimet e partive drejt përfaqësimit të barabartë gjinor. Kjo mungesë e transparencës e bënë që ky punim të kontribuoj më shumë drejt avokimit për ngritje të transparencës rreth financave të partive politike, dhe po ashtu të paraqes këndvështrimin e grave brenda partive politike rreth ndikimit të ndarjes së (pa)barabartë të buxhetit gjatë fushatave

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

---

Gratë në Kuvend (pa kuotë)



*Figura 1: Gratë anëtare të Parlamentit (në përqindje) krahasuar me anëtarët e përgjithshëm të parlamentit në Kosovë<sup>12</sup>*

Me rritjen e përfaqësimit të grave në Parlament, nevoja për të aplikuar kuotën legislative prej 30% për mandate të grave deputete ka pasur rënie të vazhdueshme ndër vite. Prej vitit 2007,

kur prej 37 grave deputete, 26 kanë marrë mandatin e tyre përmes kuotës gjinore, në vitin 2021, vetëm 12 nga gjithsej 41 gra deputete kanë hyrë përmes kësaj kuote.

---

<sup>12</sup> Burimi: Llogaritur nga faqja e internetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës: [www.kuvendiikosoves.org](http://www.kuvendiikosoves.org)

Gjithsej gra deputete

Gra në Kuvend (me kuotë gjinore)




Figura 2: Gratë anëtare të Parlamentit (në numër) përmes kuotës gjinore krahasuar me numrin total të grave deputete të Parlamentit në Kosovë.<sup>13</sup>

## ZGJEDHSHMËRIA E GRAVE DHE FINANCAT PARTIAKE

Gratë nga të gjitha partitë politike në Kosovë vazhdimisht shprehin shqetësimet e tyre se si mungesa e mbështetjes financiare nga partitë e tyre politike gjatë fushatave elektorale bëhet një barrë për financat e tyre

private dhe si e tillë pengon aftësinë e tyre për të kryer fushata të afërta të komunikimit me publikun dhe shpesh i pengon ato të angazhohen në politikë. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është një kërkesë që buron nga Ligji për Barazinë

<sup>13</sup> Burimi: Llogaritur nga faqja e internetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës: [www.kuvendiikosoves.org](http://www.kuvendiikosoves.org)

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

Gjinore dhe vlen edhe për partitë politike. Megjithatë, kjo nuk përkthehet në praktikë, duke ndikuar kështu në demokracinë dhe gjithëpërfshirjen brenda-partiake.


Për të kuptuar lidhshmërinë mes financimit të partive politike dhe fuqizimit politik të grave, duke u nisur në premisën se financimi i partive politike

duhet të marrë parasysh çështjen e gjinisë, veçanërisht duke marrë parasysh sfidat që gratë candidate për deputete në Kuvendin e Kosovës kanë në zgjedhje si pasojë e mungesës së financimit të fushatës elektorale, intervista të semi-strukturara me gra candidate nga subjektet me të mëdha politike për ulëse në Kuvend të Kosovës janë bërë në periudhën mars-prill 2021.

## RRUGËTIMI NË ZGJEDHJE PËR DEPUTETE

Të gjitha respondentet janë përgjigjur në mënyrë anonime, përdorisa përfaqësimi i subjekteve politike është i përzier, me pjesëmarrje të subjekteve parlamentare që përbëjnë legjislaturën e tetë nga zgjedhjet e fundit të vitit 2021, dhe të atyre të legjislaturës paraprake,

përkatësisht legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës. Të gjitha respondentet kanë kandiduar së paku një herë për ulësë në Kuvendin e Kosovës, përdorisa vetëm 3 nga gjithsej 8 gra, apo 37,5% e të anketuarave, kanë arritur të zgjidhen për deputete.



## KOSTO E PABARAZISË:

Figura 3: Përfaqësimi partiak i të anketuarave

Nga 5 gra sa kanë arritur të zgjedhen për deputete, vetëm 2 prej tyre janë zgjedhur përmes kuotës gjinore që

aplikohet në Kuvendin e Kosovës, përderisa 3 të tjerat janë zgjedhur me votë elektive.

## FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE

Një ndër shqetësimet kryesore që përgjithësisht gratë në politikën kosovare shprehin lidhet me mungesën e financimit të duhur të fushatës zgjedhore, si dhe koston e lartë që ndërmarrja e një fushate të mirëfilltë që u mundëson atyre mbajtjen e komunikimit të afërt politik me elektoratin e tyre, si dhe u mundëson atyre sigurimin e platformave për paraqitjen e ideve të tyre politike dhe programore për masat e gjera elektorale. Sipas të dhënave të nxjerra nga intervistat me gratë kandidate ndër subjekte politike në Kosovë, kostoja e përafërme e një fushatë zgjedhore në Kosovë shkon nga 1000 deri në mbi 5000 euro. Në fakt, 50% e respondentëve shprehin se shpenzimet e tyre për zhvillimin e një fushate zgjedhore për deputete në Kuvendin e Kosovës, kapin çmimin prej 2000-5000 eurove. 25% tjetër shprehet se shpenzojnë 1000 deri në 2000 euro për fushatë, dhe 25% thonë

që kosto financiare e fushatave të tyre zgjedhore shkon përtej 5000 eurove.





Figura 4: Kosto financiare e fushatës zgjedhore

Përderisa Ligji për Financim të Subjekteve Politike ndalon donacionet e drejtëpërdrejta për kandidatët për

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

zgjedhje lokale dhe qendrore, duke kërkuar që mjetet të kalojnë përmes subjektit politik,<sup>14</sup> donacionet private mbesin ndër format më të shpeshta të financimit të fushatave zgjedhore të kandidatëve meqë ligji nuk parasheh obligimin për deklarim të kontributeve direkte të kandidatëve politikë, por obligon vetëm partitë që të deklarojnë pranimin e kontributeve. Kjo mbështetet nga respondentet e këtij hulumtimi, me faktin që shumica e tyre pohojnë që financimi i fushatave zgjedhore që ato kanë ndërmarrë deri tani mbulohej në shkallë prej 50% nga mjetet e kombinuara mes financimit vetanake dhe subjektit politik, dhe 50% thonë të jenë vetëfinancuar tërësisht individualisht. Asnjëra nga respondentet nuk i kanë mbuluar shpenzimet e fushatës zgjedhore me mjete vetëm nga subjektve politik të cilave u takojnë.

*Asnjëra nga respondentet nuk i kanë mbuluar shpenzimet e fushatës zgjedhore me mjete vetëm nga subjektve politik të cilave u takojnë.*



*Figura 5: Ndarja e kostos financiare të fushatës zgjedhore*

Fushata zgjedhore për zgjedhje parlamentare është ndërmarrje mjaft e kushtueshme në Kosovë. Një kampanjë e suksesshme zgjedhore, përveç bazës së fortë substanciale programore, ngërthen në vete edhe një mori

<sup>14</sup> Gazeta Zyrtare. (2013). Ligji nr. 04/l-212 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 03/l-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-058. Neni 11, pika 4.

Marrë nga: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8866>

## KOSTO E PABARAZISË:

resursesh financiare dhe njerëzore që dedikohen për këtë qëllim. Shpenzimet me të shpeshta të fushatave zgjedhore në Kosovë janë shpenzimet për derivate dhe përdorim të veturave, shpenzimet për përdorim të hapësirave publike -- zakonisht restauranteve -- për mbajtje të tubimeve me elektorat, shpenzimet e promovimit medial dhe në media sociale, si dhe shpenzimet për koordinim logjistik të gjithë kampanjës.

Përderisa 50% e grate të intervistuar pohojnë që shpenzimet e tyre mbulohen nga kombimimi i mjeteve vetanke dhe atyre të subjektit politik, pyetjet në vazhdim mëtojnë të kuptojnë se në çfarë mënyre mbështeten kampanjat e grave nga subjektet e tyre politike.

Të pyetura nëse kanë pasur qasje në fonde nga subjekti i tyre politik për derivate gjatë udhëtimeve brenda fushatës zgjedhore, 75% e grave thonë që nuk pasur qasje. Vetëm 25% e grave respondente shprehen të kenë përfituar nga fondet e subjektit politik për mbulim të shpenzimeve për derivate për aktivitetet e tyre gjatë fushatës zgjedhore.



*Figura 6: A keni pasur qasje ne fonde nga partia politike për derivate gjatë udhëtimeve brenda fushatës zgjedhore?*

Ekspierencë të ngjajshme gratë kandidate brenda listave të subjekteve politike në Kosovë kanë edhe me mundësinë e tyre për qasje në vetura të subjekteve politike për të marrë pjesë nëpër tubime elektorale gjatë fushatës zgjedhore. Vetëm 25% e grave kandidate pohojnë të kenë pasur qasje ne veturat që janë në shfrytëzim të subjekteve politike pikërisht për nevoja të tilla – qasjen nëpër pika të ndryshme brenda Kosovës për të takuar dhe komunikuar me zgjedhësit e tyre.



*Figura 7: A keni pasur qasje në vetura të partisë për udhëtime nëpër tubime elektorale gjatë fushatës zgjedhore?*

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

Aspekt tjetër shumë i rëndësishëm i zhvillimit të fushatave zgjedhore është gjithashtu edhe organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve zgjedhore. Përderisa një pjesë e madhe e tubimeve me qytetarë organizohen nga subjektet politike për të gjithë listën e kandidatëve për deputetë, mbetet nën vullnetin e vetë kandidatëve për të organizuar takime dhe tubime me qytetarë përbrenda fushatës së tyre individuale. Megjithatë, për të arritur shtrirje sa më të gjerë dhe të organizuar, kandidatët zakonisht kanë nevojë për ndihmë logjistike që ofron subjekti politik. Të pyetura nëse kanë qasje në vullnetarë apo punëtorë logjistikë nga subjektet e tyre politike për zhvillim të fushatës zgjedhore, 38% e grave kandidatë thonë të mos kenë pasur qasje në resurse të tilla njerëzore, përderisa 63% e tyre pohojnë se ndihmë e tillë u është ofruar nga subjektet të cilave u takojnë.



PO → 38%

JO → 63%

Figura 8: A keni pasur qasje në vullnetarë/punëtorë logjistikë nga partia

*politike gjatë fushatës zgjedhore për të ju ndihmuar gjatë fushatës?*

Takimet dhe tubimet e kandidatëve për deputete kërkojnë hapësira zakonisht publike, kryesisht të mara me qira, për t'u organizuar. Për koston e prenotimit të hapësirave publike (restuaranteve, sallave të konferencave, lokaleve, etj.), vetëm 13% të rasteve janë përkujdesur që t'i mbulojnë subjektet politike. 50% e rasteve të rezervimeve të këtyre hapësirave publike janë paguar nga vetë kandidatët për deputete, ndërsa 38% të rasteve pagesat janë mbuluar nga donatorë privatë të respondentëve.




Figura 9: Pagimi i hapësirave publike për takime dhe tubime me qytetarë

## KOSTO E PABARAZISË:

Megjithatë, të pyetura nëse në përgjithësi gratë kandidatë respondente në këtë intervistë, ndjehen të diskriminuara nga subjektet politike pjesë e listave zgjedhore të të cilave kanë qenë, në procesin e ndarjes së resurseve humane dhe atyre financiare gjatë fushatës zgjedhore, kuptohet që shumica e grave kandidatë konsiderojnë të jenë diskriminuar në këto aspekte, përkatësisht 25% e tyre pohojnë që ndjehen të diskriminuar, dhe 38% e tyre konsiderojnë të jenë deri diku të diskriminuara në shpërndarjen e fondeve dhe resurseve njerëzore brenda partiave gjatë fushatës zgjedhore.




Figura 10: Në përgjithësi, a ndjeheni të diskriminuara në procesin e ndarjes së resurseve humane brenda partisë (për PR,

*komunikim, vozitje, sigurim) si dhe atyre financiare gjatë fushatës elektorale?*

Duke marrë parasysh rëndësinë e medias sociale për të promovuar në përgjithësi ide e mendime, e veçanërisht për të mbajtur komunikim të vazhdueshëm e interaktiv me elektoratin, ato janë mjet gati i pazëvendësueshëm i politikanëve dhe politikaneve përgjatë fushatave zgjedhore. Shtuar faktin e kostos së madhe të takimeve në person me zgjedhësit, e pamundësinë për të prekur të gjitha lokacionet brenda Kosovës, media sociale luan rol jetik në mundësimin e takimeve virtuale me qytetarë. Zhvillimi dhe përcimi i mesazhave në këto platforma, është e kushtueshme. Mbështetje financiare për promovim të postimeve politike në rrjete sociale nga subjektet e tyre politike kanë marrë vetëm 38% e grave kandidatë. Vetëm 1 në 3 gra pohon të jetë mbështetur nga subjekti politik për promovimin e mesazhave të tyre zgjedhore, duke targetuar kështu më shumë ndjekës.

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE



Figura 11: A keni pasur mbështetje financiare nga subjekti politik për promovim të postimeve tuaja (Post boosts) në rrjete sociale gjatë fushatës elektorale?

Shtabet zgjedhore brenda subjekteve politike luajnë rol kyç në organizimin e fushatës zgjedhore të një subjekti. Në shumicën e subjekteve politike, shtabet zgjedhore krijojnë rregullime të brendshme dhe strategji të caktuar edhe për paraqitjet mediale të listës zgjedhore. Të pyetyra nëse rregullimi i brendshëm i subjekteve politike lidhur me paraqitjet mediale të kandidatëve për deputetë ofron mundësi të barabarta për gra dhe burra, 50% e respondeteve konsiderojnë që rregullimi i brendshëm i kësaj çështje brenda subjektit ofron mundësi deri diku të barabarta, ndërsa 13% konsiderojnë se rregullimi i subjekteve të cilave u takojnë diskrimonon tej mase gratë.



Figura 12: Mundësitë e (pa)barabarta për qasje në paraqitje mediale

Tutje, të pyetura nëse mbështetja e subjekteve politike rreth paraqitjeve mediale të kandidatëve gra luan rol në zgjedhshmërinë e tyre, vetëm 38% e grave shohin lidhshmërinë në këtë aspekt, përderisa 63% e tyre mendojnë që zgjedhshmëria e tyre varet edhe nga mbështetja e subjektit politik që u jep atyre për të pasur më shumë mundësi për paraqitje mediale.

## KOSTO E PABARAZISË:




Figura 13: A mendoni se mbështetja e subjektit rreth paraqitjeve mediale ka ndikim në zgjedhshmërinë e kandidatëve?

Në anën tjetër, shumica e respondentëve konsiderojnë që në fakt paraqitjet mediale të grave, apo mungesa e tyre në media, luajnë rol në zgjedhshmërinë e tyre për deputete. Meqë mediat kanë fuqi të madhe dhe transformuese në socializimin e masave lidhur me rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha proceset dhe forumet vendimmarrëse dhe politikëbërëse, mungesa e grave në këto medime ndikon direkt edhe në zgjedhshmërinë e tyre si deputete.





Figura 14: A mendoni se paraqitjet mediale të grave ose mungesa e tyre, luajnë rol në (mos)zgjedhshmërinë për deputete?

Për të vlerësuar nëse një subjekt politik zbaton praktika diskriminuese ndaj grave në shpërndarjen e resurseve financiare të dedikuara për fushatë zgjedhore, është e rëndësishme që subjektet politike të jenë transparente në menaxhimin dhe mënyrën e shpërndarjes së resurseve të cilat i posedojnë. Vetëm 1 në 4 respondente (25%) pohojnë që brenda subjekteve të tyre politike ka transparencë në menaxhimin e resurseve financiare duke ofruar qasje të plotë në menaxhimin financiar, dhe 25% tjera pohojnë që menaxhimi financiar është vetëm deri diku transparent. Përderisa 25% pohojnë

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

që subjektet e tyre nuk janë transparente ku nga këto 13% thonë që qasja në menaxhimin financiar të subjektit politik është e pamundur.

Për fund, respondentet janë të ndara në përgjigjen lidhur me mendimin e tyre në atë se sa mirren parasysh çështjet e grave në menaxhimin dhe shpërndarjen e resurseve financiare për kandidatet gra dhe nëse ato mendojnë që janë të diskriminuara në këtë proces.



■ Çështjet e grave trajtohen deri diku në këtë proces

■ Çështjet e grave janë rrënjësore dhe gratë janë pjesë e gjithë procesit të menaxhimit të shpërndarjes së resurseve financiare

■ Çështjet e grave nuk trajtohen fare në këtë proces

*Figura 15: A mendoni se mbështetja e subjektit rreth paraqitjeve mediale ka ndikim në zgjedhshmërinë e kandidatëve?*

25% e grave konsiderojnë se çështjet e grave nuk trajtohen fare në këtë proces,

ndërsa 50% e tyre pohojnë se në subjektet e tyre politike këto çështje trajtohen deri diku gjatë fushatës zgjedhore. Vetëm 25% e respondentëve thonë që për subjektet e tyre çështjet e grave janë rrënjësore dhe se gratë janë pjesë e gjithë procesit të menaxhimit dhe shpërndarjes së resurseve financiare.

### Sfidat kryesore në rrugën për deputete

Të gjitha gratë kandidate për deputete, respondente të kësaj interviste, konsiderojnë që përveç sfidave kulturore dhe tradicionale të një elektorati në masë të madhe patriarkal, mbështetja nga subjekti politik si dhe financimi i fushatës zgjedhore mbeten ndër barrierat e tyre kryesore në rrugëtimin e tyre në zgjedhje parlamentare. Sipas një respondente, “sfida kryesore mbeten financat, dhe për këtë arsye secila parti duhet të ketë fondin e veçantë për gratë kandidate.” E pyetur për sfidat kryesore gjatë fushatës, edhe respondentja tjetër pohon se “financimi është temë kryesore që e determinon edhe motivimin e kandidatës.” Një

respondente konsideron se “Financimi ndikon por nuk është përfundimtar. Sfidë në vete është preferenca gjinore e elektoratit deri diku konservator”. Për disa respondente, mungesa e mbështetjes financiare përkthet direkt edhe në mungesë të mbështetjes së subjektit politik për garën e tyre si gra kandidatë. Saktësisht, një respondente është shprehur se sfidat kryesore e saj në rrugën për të arritur një ulëse legjislative janë “mungesa e resurseve, si dhe mbështetja e pamjaftueshme nga strukturat e partise.”

*Financimi ndikon por nuk është përfundimtar. Sfidë në vete është preferenca gjinore e elektoratit deri diku konservator*

### Financimi i fushatës zgjedhore në sytë e subjekteve politike

Për të kuptuar qasjen e subjekteve politike në ndarjen e financimit politik të fushatave zgjedhore, janë intervistuar zyrtarë të financave brenda pesë subjekteve pjesëmarrëse të këtij raporti.

Sipas tyre, në përgjithësi, subjektet politike ballafaqohen me mungesë të mjeteve të mjaftueshme për të mbështetur kandidatët gra dhe burra në lista zgjedhore. Duke marrë parasysh këtë, sipas zyrtarëve financiarë, subjektet politike sigurohen që mjetet e ndara për fushatë zgjedhore të alokohen barazisht tek të gjithë kandidatët. Qasje e njëjtë vlen, sipas tyre, edhe për shpërndarjen e resurseve humane në kohë fushate, përdorimit të veturave zyrtare, sponsorizimeve dhe paraqitjeve mediale, si dhe mjeteve të tjera të nevojshme në kohë fushate.

Megjithëse në dijeni se gratë kandidatë ballafaqohen më shumë me mungesë të fondeve, subjektet politike konsiderojnë që e kanë të pamundur të krijojnë fonde të veçanta për to, apo të sigurojnë mbështetje më të mëdha për financim të fushatës zgjedhore të kandidatëve gra.

Shumica e subjekteve politike sigurohen që në mënyrë të barabartë të u printohen broshura promovuese kandidatëve, fotografi profesionale për fushatë, si dhe të mbulojnë shpenzimet e tubimeve të përbashkëta të kandidatëve. Të gjitha shpenzimet e

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

---

tjera për takime individuale me qytetarë, i takojnë kandidatëve të sigurojnë financim për to. Rrjedhimisht, subjektet politike mirëmbajnë praktikën

e vetëfinancimit apo financimit përmes donatorëve privatë të kandidatëve, pa kërkuar raporte financiare për ato donacione.

### PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Parimi i barazisë gjinore është i rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe me ligjet tjera të zbatueshme. Sipas Kushtetutës të dy gjinitë kanë të drejta të barabarta për pjesëmarrje në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe në fushat tjera. Megjithatë, praktika shpërfaqë pasqyrë tjetër. Gratë mbeten të nënpërfaqësuar në të gjitha fushat publike, e sidomos në politikë. Kjo ndodh si rezultat i kulturës dhe traditave rigjide patriarkale që prodhon elektorat rrjedhimisht konservator me ide të paracaktuara për rolet gjinore të grave dhe burrave në fushë publike, si dhe mungesës së vullnetit politik dhe mbështetjes brenda subjekteve politike për të ndihmuar fuqizimin politik të grave. Faktor i rëndësishëm i mirëmbajtjes së hendekut ekzitues gjinor në politikë janë edhe financat e munguara për gra politike, sidomos në kohë të fushatës zgjedhore.

Finacimi politik i fushatave zgjedhore është zgjidhje, por kur ai bëhet në mënyrë jotransparente dhe jogjithëpërfshirëse, bëhet edhe problem. Mungesa e qasjes gjinore në rregullimin e financimit politik të subjekteve politike – me prioritizim të mbështetjes brendapartiake për fuqizimin e grave në listat zgjedhore – krijon hapësirë për mirëmbajtjen e hendekut gjinor ekzitues në politikën kosovare. Shpërndarja e pabarabartë e resurseve financiare dhe atyre humane të dedikuara për zhvillimin e fushatave zgjedhore të subjekteve politike në Kosovë, krijon kushte diskriminimi për gra qysh në start, duke u zvogëluar mundësitë për zgjedhje për ulëse parlamentare. Rrjedhimisht, mungesa e financimit politik të fushatave zgjedhore të grave kandidate, në rastin më të keq dekurajon pjesëmarrjen e tyre në procese zgjedhore, por edhe detyron gratë që i hynë garës zgjedhore të bartin barrë të madhe financiare në zhvillimin e fushatës dhe mbajtjes së komunikimit me elektorat.

Mungesa e mbështetjes së barabartë për burrat dhe gratë në paraqitje mediale gjatë kohës së fushatës zgjedhore ndikon dukshëm në moszgjedhshmërinë e tyre si deputete. Privimi i shfrytëzimit të hapësirës dhe platformave mediale për komunikim masiv të ideve dhe planprogrameve tek zgjedhësit luan rol në nënpërfaqësimin e grave në politikë.

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

---

**Për të ballafaquar dhe tejkaluar sfidat që grave në këto kushte u imponohen gjatë fushatave zgjedhore, rekomandimet kryesore janë:**

### Për subjektet politike

- ~ Vullnet të rritur brenda subjekteve për pjesëmarrje substantive të grave në procese zgjedhore, duke siguruar kushte të përshtatshme për zhvillim të fushatës zgjedhore të grave kandidatë, duke rritur financimin e fushatës, dhe krijim të hapësirës për paraqitje të shtuara mediale për to.
- ~ Të sigurohet financimi i njësisë të organizimit të grave brenda subjekteve politike, në përputhje me Ligjin për Financim të Subjekteve Politike. Mjetet e ndara për këto forume mund të përdoren për trajnime për fuqizim politik të grave, komunikim politik, si dhe për nevojat të fushatës zgjedhore të grave kandidatë.
- ~ Subjektet politike të bëjnë studime cilësore për pengesat kryesore në rrugëtimin politik të grave kandidatë për zgjedhje. Kuptimi i nevojave, prioritetëve, dhe kërkesave kryesore të grave në procese zgjedhore, dhe krijimi i kushteve për përmirësim të situatës, rrit motivimin e grave për pjesëmarrje politike dhe ndikon në zgjedhshmërinë e tyre në proces zgjedhor.
- ~ Të krijojnë mekanizma dhe rregullore të brendshme që sigurojnë ndarjen e buxhetit dhe resurseve, me fokus të veçantë në mbështetjet për paraqitjet mediale, të subjektit politik në mënyrë të barabartë për gra dhe burra.
- ~ Publikimi i detajzuar dhe brenda afatave i deklarimeve financiare të fushatave elektorale.

### Për politikëbërësit

- ~ Të bëhet analizë gjinore e Ligjit për Financim të Subjekteve Politike, duke u siguruar që provizionet ligjore të këtij ligji nuk janë neutrale për gjini, dhe marrin parasysh nevojat dhe kërkesat e grave në procese zgjedhore.
- ~ Të mirren parasysh norma të reja ligjore për financimin e grave candidate në zgjedhje të përgjithshme dhe lokale, në mënyrë që të tejkalohen sfidat financiare të grave për pjesëmarrje në procese zgjedhore.
- ~ Të ndermerret harmonizimi i Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, Ligjit për Zgjedhje Lokale, Ligjit për Financim të Subjekteve Politike, me Ligjin për Barazi Gjinore për garantimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave në politikë. Të krijohen norma ligjore që sanksionojnë mosrespektimin e Ligjit për Barazi Gjinore në instancat e tjera normative.

### Për shoqërinë civile

- ~ Është e rëndësishme që të bëhen studime empirike me analizë gjinore për financimin politik në Kosovë, përmes të cilit kuptohen saktësisht praktikat e subjekteve politike në shpërndarjen e financave për gratë dhe burrat, dhe që inkurajon praktikë transparente dhe llogaridhënëse të subjekteve politike në mënyrën e fitimit dhe shpërndarjes së fondeve politike.
- ~ Të drejtohen përpjeket e organizatave të shoqërisë civile për edukim të votuesëve/eve lidhur me rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në politikë, dhe mbështjetjes së tyre në zgjedhje.
- ~ Të ofrohet hapësirë më e shtuar nga mediat për paraqitje mediale të grave candidate nëpër debate televizive dhe përputhje me kundërkandidatë/e në tema të ndryshme politike.

## FINANCIMI POLITIK I FUSHATËS ZGJEDHORE

---

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

32:055.2(496.51)(047)

324(496.51)

Kosto e pabarazisë : Financimi fushatës zgjedhore së grave kandidate / përgatitur nga Valëza Zogjani. - Prishtinë : Demokracia për Zhvillim, 2021. - 34 f. : ilustr. ; 24 cm.

Zgjedhjet -- Kosovë


Gratë -- Kosovë

Kosova-- Politika dhe qeverisja

**ISBN 978-9951-823-13-5**

Aleph [000098571]

ISBN 978-9951-823-13-5



9 789951 823135



Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë.

Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë.

D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndër-sektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: [www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org).

Ky publikim është përkrahur nga:



British Embassy  
Pristina

